



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.946/2024**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles së Dytë**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore paditësit/propozuesit të masës së sigurimit "PIONIR" D.O.O., me seli ne Beograd, të cilin sipas autorizimit të përfaqëson J.F., avokate nga Graçanica, kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit "Molitoria" shpk me seli ne Navlan, Komuna e Vushtrrisë, me NUI:71325407, të cilin sipas autorizimit të përfaqëson Av. A.Rr. nga Prishtina, për shkak të caktimit të masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të masës së sigurimit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Departamenti Ekonomik, KE.nr.609/2023, i datës 22.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.**30/04/2024**, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa themeltë ankesa kundërshtarit të masës së sigurisë "Molitoria" shpk me seli ne Navlan, Komuna e Vushtrrisë dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Departamenti Ekonomik, KE.nr.609/2023, i datës 22.02.2024.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar e ka aprovuar në tërësi si të bazuar propozimin e palës propozuese "PIONIR" D.O.O., me seli ne Beograd, të cilin sipas autorizimit të përfaqëson J.F., avokate nga Graçanica, ku dhe ka caktuar masën e sigurisë, ndaj kundërshtarit të sigurimit "Molitoria" shpk me seli ne Navlan, Komuna e Vushtrrisë, me NUI:71325407, të cilin sipas autorizimit të përfaqëson Av. A.RR. nga Prishtina, me të cilën është detyruar kundërshtari i sigurimit që të ndërprejë të gjitha veprimet që shkelin të drejtën e propozuesit në mbrojtje të markave tregtare në Republikën e Kosovës, në piken e dyte të dispozitivit ka vendosur që të urdhërohet kundërshtari i sigurimit, që të terhjek nga tregu qarkullimin e produktit i cili cenon markën tregtare të propozuesit të sigurimit, et regjistruar sipas numrit 22053. Kurse sa i përket shpenzimeve ka vendosur që secila palë të i barte shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kundërshtari i masës së sigurimit "Molitoria" shpk me seli ne Navlan, Komuna e Vushtrrisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar të gjendjes faktik dhe aplikimit të gabuar të ligjit materiale, me propozimin që shfuqizohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Departamenti Ekonomik, KE.nr.609/2023, i datës 22.02.2024 sa i përket lëndës aktvendimit mbi masën e sigurimit në tërësi me të gjitha pikat e aktvendimit si të kundërligjshëm.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur propozuesi i sigurimit, me propozim qe te refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe te vërtetohet aktvendimi i atakuar.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

#### **-Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - propozuesi i masës së sigurisë propozuesit/ paditësi "PIONIR" D.O.O., me seli ne Beograd, me datën 07.08.2023, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit/ padituri "Molitoria" shpk me seli ne Navlan, Komuna e Vushtrrisë, me propozimin që të aprovohet kërkesa e propozuesit të masës se sigurisë dhe të caktohet masa e sigurisë ndaj kundërshtarit të masës së sigurisë dhe të detyrohet kundërshtari i sigurimit të ndërprejë të gjitha veprimet qe shkelin të drejtën e propozuesit ne mbrojtjen e markave të regjistruara tregtare në Republikën e Kosovës. Ne seancën e datës 22.02.2024 duke vendosur sipas propozimit te propozuesit, gjykata ka marre aktvendim me te cilin ka aprovuar propozimin, e propozuesit te masës siguruese.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, me aktvendimin e atakuar, e ka aprovuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, si të bazuar, duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me Nenin 297 par.1 pikat a) dhe b) të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdhe në përfundim se ankesa është e pabazuar, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktvendimit është i kuptueshëm, nuk është kontradiktor me vetvete si dhe nuk ekzistojnë kundërhënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktvendimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht në arsyetim të aktvendimit janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare.

Po ashtu gjykata e shkalles se dyte, ka vlerësuar se produkti "Honey Heart" me prodhues "Molitoria" shpk me seli ne Navlan, Komuna e Vushtrrisë, si ne aplikimin për regjistrim te markës tregtare, e ashtu edhe ne dukje i ngjason produktit "Medeno Srce (Honey Heard)", meqë ka përdorim identik te ngjyrave te cilat produkti Medeno Srce, produkt i mbrojtur si marke tregtare me vendim te mëparshëm. Konkretisht produkti "Honey Heart" e prodhuesit "Molitoria" shpk me seli ne Navlan,

Komuna e Vushtrrisë, ne tërësi ne ambalazhin figuron forma e zemrës ngjyrat e njëjta te produktit i cili produkt është i mbrojtur si marke tregtare dhe e cila ne shikim te pare mund te shkaktoje konfuzion tek nje konsumator i rendomte me rastin e blerjes se produktit, ashtu qe duke dashur te blejë produktin "Medeno Srce (Honey Heart) te prodhuesit Pionier D.O.O merr Honey Heart" e prodhuesit "Molitoria" shpk me seli ne Navlan, Komuna e Vushtrrisë. Për gjykatën ishte evident ky konfuzion i konsumatorit posaçërisht nëse i referohemi grup moshave te klientëve te cilët janë konsumatorë te rregullt te produkteve te lartpërmendura. Me regjistrim te markës tregtare i pari - Propozuesi Pionir D.O.O për produktin Honey Heart" ka siguruar te drejtën e përparësisë se markës tregtare te mbrojtur si marke e regjistruar mëhershëm dhe njëkohësisht ne baze te shkresave te lëndës konstatohet se ka një shtrirje ne tregun e Kosovës për një kohe te gjate.

Meqenëse kemi te bëjmë me produkte nga klasa 30 sipas klasifikimit ndërkombëtar te Nices për produkte dhe shërbime, gjegjësisht me produkte te ëmbëlsirave, për te cilat propozuesi e ka te mbrojtur markën tregtare për produktin Honey Heart dhe me te drejte përparësie ndaj një aplikuesi tjetër, gjykata nuk mund te lejoje ndërmarrjen e veprimeve nga ana e kundërshtarit te masës të cilat e dëmtojnë propozuesin si ne plasman në treg e po ashtu edhe me reputacion, deri ne një vendim te Agjencisë për Pronësi Industriale për regjistrim apo jo të markës së kundërshtarit të sigurimit.

Po ashtu gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se sipas Ligjit për Markat Tregtare Nr. 8/L-075 (tutje LMT), gjykata mund te shqiptoj masën e sigurimit ne rastet e shkeljes se markës tregtare nëse pronari i markës dëshmon se marka është shkelur apo tenton te shkelet. Neni 79 paragrafi 1 i LMT-se përcakton se: "1. Me kërkesën e pronarit te markës tregtare i cili dëshmon se marka tregtare është shkelur apo tentohet te shkelet, gjykata mund të shqiptoj çfarëdo mase te përkohshme qe përfshin ndalimin apo parandalimin e shkeljes dhe ne veçanti: 1.1. të urdhëroj shkelësin e supozuar qe t'i ndaloje dhe t'i ndërpresë veprimet qe shkelin markën tregtare; gjykata po ashtu mund të lëshojë një urdhër ndalimi kundër ndërmjetësuesit shërbimet e te cilit i përdorin personat e trete qe shkelin markën tregtare; 1.2. te urdhëroj konfiskimin apo largimin nga tregu te produkteve qe pa te drejte emërtohen si marka tregtare."

Gjykata duke u bazuar ne nenin 9 par.2 nën par 2.2 te LMT-se, me te cilin përcaktohet se: "2. Pronari i markës tregtare të regjistruar ka te drejte të ndaloje të gjitha palët e trete qe nuk kanë pëlqimin e tij qe ta përdorin atë gjatë afarizmit tregtare, lidhur me mallra apo shërbime, çfarëdo shenje qe: ... 2.2. është identike ose e ngjashme me markën apo qe, për shkak te njëllojshmërisë apo ngjashmërisë se mallrave ose shërbimeve, për te cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, qe mbulohen nga marka e regjistruar, mund te shkaktojnë konfuzion të publiku lidhur me markën tregtare,", gjen se ne rastin konkret propozimi i propozuesit te masës se sigurimit është i bazuar meqenëse i njëjti ka provuar se marka e tij tregtare është cenuar nga kundërshtari i sigurimit e po ashtu ka arritur ta vërtetoj se pa caktimin e kësaj mase, kundërshtari i sigurimit do te vazhdonte me shkeljen e markës tregtare te propozuesit te masës se sigurimit dhe dëmtimin e tij

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se kundërshtari i sigurimit nuk ka te drejte qe te përdorë shenjat me emërtimin "Honey Heart", te kombinuara me ngjyrën e kuqe, te bardhe, kafe dhe te zeze, ku emri i produktit është i shkruar ne pjesën qendrore me ngjyrë te bardhe, me imazhin e produktit te stilizuar ne forme te zemrës dhe te lugës se drurit, për shkak se me dispozitat e LMT-s, pronari i një

marke te regjistruar nuk ka nevojë të vërtetohet konfuzionin që faktikisht është krijuar nga përdorimi i markës identike ose të ngjashme, por vetëm mundësinë e krijimit të një konfuzioni tek konsumatorët.

Gjykata Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe si i tillë mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 181 par.1 e lidhur me nenin 297 të LPK-së dhe nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, e që eventualisht do të mund të përbejë arsye për anulimin e këtij aktvendimi, e po ashtu aktvendimi i atakuar është marre ne përputhje me të drejtën materiale, Ligjin për Marka Tregtare, neni 79.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë,**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.946/2024, dt.30.04.2024**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Faton Bajrami, d.v**